



# MEKTRIN MOTORS

Autostrada Durres-Tirane, Km 6, Durres, Albania  
NIPT: K51408501P  
Tel : +355 69 70 50 800  
E-mail: info@mektrin.al  
Web: www.mektrin.al

## Raporti vjetor 2018

### Treguesit kryesorë financiarë

#### Pasqyra e performancës

		2018	2017
Të ardhurat	Në lekë	2,429,204,986	3,777,302,687
Fitimi bruto	Në lekë	281,454,725	324,179,061
Fitimi para interesave, tatim fitimit dhe amortizimit (FPITA)	Në lekë	246,480,220	290,212,414
Fitimi para interesave, tatim fitimit (FPIT)	Në lekë	203,093,821	263,831,397
Fitimi para interesave	Në lekë	187,054,900	252,304,799
Fitimi neto	Në lekë	158,064,998	213,023,093

#### Pozicioni financiar

Aktivet afatgjata	Në lekë	869,927,181	723,478,935
Aktivet afatshkurtra	Në lekë	962,820,763	1,100,646,026
Kapitali	Në lekë	1,006,222,030	848,157,032
Detyrimet	Në lekë	826,525,914	975,967,929
Totali i akitivit / pasivit	Në lekë	1,832,747,944	1,824,124,961

#### Treguesit kryesorë financiarë

Cash flow nga aktiviteti operativ	Në lekë	29,569,595	174,817,064
Gjëndja e likuiditeteve më 31 Dhjetor	Në lekë	35,497,342	88,815,407
Raporti i likuiditetit korent		1.78	1.60
Raporti i kapitalit	Në përqindje	26.66	35.93
Norma e kthimit të kapitalit	Në përqindje	8.62	11.68

### Çështjet kryesore 2018

Konsolidimi i pozicionit të fituar në treg  
Rritje e numrit të fuqisë punëtore  
Rritje e cilësisë së shërbimit  
Modernizimi i sistemit manaxherial  
Vazhdimi i investimeve



## MEKTRIN MOTORS

Autostrada Durres-Tirane, Km 6, Durres, Albania  
NIPT: K51408501P  
Tel : +355 69 70 50 800  
E-mail: info@mektrin.al  
Web: www.mektrin.al

Shoqëria Mektrin Motors shpk, e themeluar në vitin 2005, ushtron aktivitet në tregtimin, dhënien me qira dhe mirëmbajtjen e automjeteve.

Viti 2018 është karakterizuar nga konsolidimi i tregut të sektorit pavarësisht nga rënia e fitimit, por me një rritje në vlerën e aktiveve afatgjata.

Rritja e vitit 2017 u karakterizua nga një rritje shumë e konsiderueshme e eksporteve, ndërsa në vitin 2018 eksportet patën një rënie të konsiderueshme.

### Rezultati financiar

Të ardhurat totale janë në 2'429'205'000 lekë, me një rënie prej 36% nga viti i kaluar.

Ndikimin kryesor në të ardhurat e ka sjellë:

1. Rënia e shitjeve të eksportimit të automjeteve prej 80%, ndërkohë që shitjet brenda vendit kanë një rritje prej 5%.
2. Rritja e të ardhurave nga shitja e pjesëve të këmbimit prej 7%
3. Rritja e të ardhurave nga shërbimet prej 40%
4. Rritja e shpenzimeve për paga, amortizimeve, të tjera operacionale dhe e interesave financiare.

Fitimi përpara interesave, tatimit dhe amortizimit (FPITA) rezultoi me një fitim prej 246'480'000 lekë.

Pavarësisht nga rënia e fitimit, investimet në aktivet afatgjata neto kanë rezultuar me rritje, nga 723'478'000 lekë në vitin 2017 në 869'721'000 lekë me një rritje prej 20%.

Detyrimet rezultuan me ulje prej 19% nga 975'968'000 lekë në vitin 2017 në 826'526'000 lekë.

Cash flow nga aktiviteti operacional rezultoi pozitive me 29'570'000 lekë

Cash flow nga aktiviteti i investimit rezultoi negative me 198'396'000 lekë

Cash flow nga aktiviteti i financimit rezultoi pozitiv me 115'509'000 lekë.

### Parimi i vijueshmërisë

Pasqyrat financiare bazuar në standartet ndërkombëtare të kontabilitetit dhe raportimit financiar janë përgatitur mbi supozimin e vijueshmërisë dhe se këto kushte ekzistojnë realisht.

### Segmenti i tregut të aktivitetit:

Segmenti përfshin:

Shitjen e automjeteve në të cilin u realizuan të ardhura prej 2'061'659'000 lekë

Shitja e pjesëve të këmbimit në të cilin u realizuan të ardhura prej 169'310'000 lekë

Të ardhura nga riparime mirëmbajtje dhe shërbime të tjera prej 26'471'000 lekë.



## **MEKTRIN MOTORS**

Autostrada Durres-Tirane, Km 6, Durres, Albania  
NIPT: KS1408501P  
Tel: +355 69 70 50 800  
E-mail: info@mektrin.al  
Web: www.mektrin.al

### **Rishikimi i riskut.**

Aktivitetet më të ekspozuara ndaj rreziqeve dhe që kanë peshën kryesore të aktivitetit janë:

Shitja e automjeteve.

Shitja e pjesëve të këmbimit.

Riparime mirëmbajtje dhe shërbime të tjera.

### **Kontrulli i brëndshëm dhe rreziku i drejtimit.**

Shoqëria është e angazhuar në administrimin e rrezikut të drejtimit në një mënyrë konstante, duke i kushtuar një rëndësi të veçantë. Për të arritur këtë qëllim, organi drejtues aplikon një mënyrë drejtimi të përgjegjshme dhe procedura të kontrollueshme për zvoglimin e këtij rreziku, të cilat kanë dhënë rezultat pozitiv në fitimin dhe kontrollin e shpenzimeve. Organet drejtuese dhe i gjithë stafi janë në dijeni të kushteve të ambjentit ku ata operojnë, zbatojnë masat për zvoglimin e rrezikut, përgatiten për të vepruar në perballje të pazakonta, kërcënime apo incidente dhe i përgjigjen rreziqeve për të minimizuar pasojat.

### **Rreziku i Tregut.**

Kërkesa në lidhje me grupin e shërbimeve dhe mallrave të ofrura janë në nivele të ndryshme, të lidhura me aktivitetin global ekonomik në Shqipëri.

### **Ambjeniti i punës, Siguria dhe Shëndeti.**

Aktiviteti i shoqërisë udhëhiqet nga respektimi i të drejtave njerzore dhe të standarteve të Kodit të Punës, të cilat përfshijnë gjithashtu edhe parandalimin e shfrytëzimit të minorenëve, respektimin e pagës minimale, kushtet e punës dhe lirinë e sindikatave. Gjatë vitit 2018 numri I aksidenteve ka qenë zero.

### **Organizimi dhe zhvillimi I burimeve njerzore.**

Shoqëria ka në fund të vitit 2018 55 punonjës. Ajo u ofron kushte dhe mundësi të barabarta të gjithë punonjësve, pa dallim gjinie, moshe, prejardhje dhe race. Cdo lloj diskriminimi është i papranueshëm. Shoqëria I kushton rëndësi të veçantë edhe trainimit të brezit të ri.

### **Shpërndarja e fitimit.**

Drejtimi ka propozuar që fitimi I vitit 2018 të kalojë i gjithi në rezerva, me qëllim rritjen dhe zhvillimin e metejshëm të aktivitetit.




## MEKTRIN MOTORS

Autostrada Durres-Tirane, Km 6, Durres, Albania  
NIPT: K51408501P  
Tel : +355 69 70 50 800  
E-mail: [Info@mektrin.al](mailto:Info@mektrin.al)  
Web: [www.mektrin.al](http://www.mektrin.al)

### Perspektiva

Mektrin Motors Shpk, është një shoqëri lider në tregun e automjeteve. Shoqëria do të vazhdojë të forcojë në mënyrë të qëndrueshme pozitën në këtë treg.



Z. Edmond Shahini  
Administrator

